



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVË	
MINISTRIE E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVO	
MINISTRY OF HEALTH	
Titulli Org. Org. Unit	8.1
Nr. Prot. Prot. No.	05-981
Nr. i faqëve Gr. Stranica No. pages	- 2 -
Data: Datum:	11 / 02 / 20 25
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara - Office of the General Secretary
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore - Jedinica za upravljanje ljudskim resursima
Human Resources Management Unit

Datë: 11.02.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në njoftimin e datës 20/12/2024 dhe re-njoftimin e datës 07/01/2025 nga KPMSHCK, si dhe bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare Nr. 21, 18 shtator 2023) dhe Rregullores (QRK) Nr.15/2023 Për procedurën e pranimit në shërbimin civil, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Anullohet procedura e rekrutimit me nr. ref. RN00016018, e shpallur më 11/12/2024, për pozitën Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Procedura e rekrutimit me nr. ref. RN00016018, e shpallur më 11/12/2024, për pozitën Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore, bazohet në njoftimin e datës 20/12/2024 dhe re-njoftimin e datës 07/01/2025 nga KPMSHCK, të cilët informojnë se marr për bazë dispozitat e nenit 130 paragrafi 1 dhe nenit 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, se aktet ndaj të cilave parashtrohet ankesë në Këshill, nuk mund të ekzekutohen pasi që sipas fuqisë së ligjit, parashtrimi i një ankese pezullon sipas fuqisë së ligjit prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën..

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lart, dhe meqë kanë kaluar afatet ligjore për zhvillim të procedurës së rekrutimit, anulohet procedura me qëllim të rishpalljes pas marrjes së konfirmimit nga komisioni përkatës qeveritar për koeficientin e pagës për këtë pozitë.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim, mund të ushtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, në afatin prej 30 ditësh prej marrjes së këtij vendimi.

Haki Smajli

Udhëheqës i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve

Vendimi i dërgohet:

- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Arkivit të MSh-së.*